



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-2600/14 Prot No
Nr. i faq. Broj stranica 02 Nr. pages	Data Datum 11.07.2014 Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1698/14, për z. Mehmet Gjokaj – Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1698/14, për z. Mehmet Gjokaj – Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar dhe njëkohësisht pronar i vetëm në biznesin privat N.N.SH. “Delta - x”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarit të lartë z. Gjokaj, së pari i është bërë shkresa zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për njoftimin e fillimit të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së Konfliktit të Interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është takuar me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Ai është bindur me fakte për ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

z. Gjokaj ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të autorizoj një person të besueshëm për të udhëhequr këtë biznes, në mënyrë që të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2493/14) me të cilën vërtetohet se ai ka autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin privat N.N.SH. "Delta - x".

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

